Ç' ËSHTË DHUNA BASHKËSHORTORE OSE NË FAMILJE?

DHUNA BASHKËSHORTORE OSE NË FAMILJE MUND TË JETË:

DHUNË ADMINISTRATIVE: kur dikush ju kërcënon që t'ju heqë letrat (statusin e qëndrimit) ose të ktheheni në vendin tuaj

DHUNË FINANCIARE: kur dikush ju lë pa para, ushqim apo pa ngrohje

DHUNË FIZIKE: kur dikush ju godet, ju shtyn apo ju mbyt (ju vë duart në fyt)

DHUNË SEKSUALE: kur dikush ju imponon ose ju detyron të kryeni marrëdhënie seksuale pa dëshirë

DHUNË VERBALE: kur dikush ju fyen, ju kërcënon

DHUNË PSIKOLOGJIKE: kur dikush ju kërcënon, ju izolon, ju pengon që të studioni dhe të punoni, ju poshtëron dhe ju diskrediton

JU DHE FËMIJËT TUAJ KENI TË DREJTAT E MËPOSHTME

Ju keni të drejtën **të jetoni** pa dhunë. Dhuna bashkëshortore ose në familje dënohet me ligj në Belgjikë.

Ju keni të drejtë të flisni lidhur me dhunën, me njerëzit që ju rrethojnë të cilët mund t'ju ndihmojnë dhe t'ju orientiojnë si p.sh.: familja doktori juaj i familjes, zyra kombëtare për fëmijët (ONE), shkolla....etj.

Ju keni **të drejtë po kështu, të thërrisni ndihmën e shpejtë dhe të denonconi në polici**.

Edhe pse statusi i qëndrimit varet nga jeta e përbashkët me bashkëshortin, bashkëshorten ose familjen, keni të drejtën që **të largoheni nga shtëpia**.

Kërkoni dhe ruajini provat e dhunës si p.sh: certifikatat mjekësore, proçes-verbalet e policisë, dëshmitë, fotografitë, email-et, mesazhet, regjistrimet...



Për të ruajtur **statusin e qëndrimit**, ju duhet të plotësoni disa kërkesa të caktuara. Mund të ndihmoheni nga një avokat apo nga shërbime të specializuara lidhur me këtë punë.

KUSH MUND TË MË NDIHMOJ?

JU NUK JENI VETËM; SHËRBIME TË NDRYSHME MUND T'JU NDIHMOJNË:

Për t'u **DËGJUAR**, për një **INFORMACION**, **ORIENTIM** si p.sh (gjetja e strehimit, gjetja e një shërbimi juridik, **mbështetje sociale** ose **psikologjike** etj.)

0800 30 030 (24 orë në ditë, falas dhe anonim) ose bashkëbisedoni në faqen e internetit
www.ecouteviolencesconjugales.be

NË RAST RREZIKU. Telefononi **policinë** në nr. **101** ose kërkoni **ndihmën e shpejtë** në nr. **112.**

Écoute Violences Conjugales
0800 30 0 30
24/7 + GRATUIT + ANONYME
www.ecouteviolencesconjugales.be

Ky dokument është nxjerrë nga broshura "*Emigrant (e) dhe viktimë e dhunës bashkëshortore, cilat janë të drejtat e mia*", e përgatitur nga "CIRE" dhe nga platforma e shoqatës së Brukselit "ESPER".

Éditeur responsable : Françoise LANNOY - SPW - Av. Gouverneur Bovesse, 100 - 5100 Namur - Novembre 2019 ALBANAIS

JENI EMIGRANT (E) DHE VIKTIMË E DHUNËS BASHKËSHORTORE?

KENI ARDHUR NË BELGJIKË PËR T'U BASHKUAR ME NDONJË PJESËTAR TË FAMILJES SUAJ DHE PO PËRJETONI NJË GJENDJE DHUNE NË FAMILJE?

Écoute Violences Conjugales
0800 30 0 30
24/7 + GRATUIT + ANONYME

Wallonie